

VENDIM
Nr. 667, datë 7.8.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË
BARABARTA PËR PUBLIKIMIN E NJOFTIMEVE PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME
OBJEKT “REHABILITIMI I ISH-REPARTIT USHTARAK NË QENDËR PRITËSE PËR TË
PASTREHËT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për publikimin e njoftimeve për procedurën e prokurimit, me objekt “Rehabilitimi i ish-repartit ushtarak në qendër pritëse për të pastrehët”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha